



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 63/38 Prot.

Tiranë më, 07.11.2024

V E N D I M

Nr. 52 datë 07.11.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Loreta Hanxhari	Kryesuese
Bora Vrenjo	Relatore
Henri Naqellari	Anëtar

asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik Znj. Ersila Kalaja, në datën 07.11.2024, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z. Besnik Çerçiz Kongjonaj** me funksion aktual Drejtor i Qendrës së Mbyllur të të Huajve.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj.Bora Vrenjo; shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar si edhe dëgjoji subjektin në seancën dëgjimore,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni përgjegjës për kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
2. Subjekti i vlerësimit kalimtar, Z. Besnik Kongjonaj ka dorëzuar *deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*, për funksionin Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, sipas përcaktimeve të neneve 32, pika 2, 36 pika 1, dhe 44 pika 1, të Ligjit Nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
3. Bazuar në nenin 6 të Ligjit nr.12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar, Besnik Kongjonaj është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit Zëvendës drejtor për Sigurinë Publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, në datën e zhvillimit të shortit.
4. Subjekti i vlerësimit, Besnik Kongjonaj, iu nënshtrua procedurës së shortimit, në shortin e zhvilluar në datën 04.07.2023, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07 datë 17.01.2023 *“Për Procedurat dhe Mënyrat e Hedhjes së Shortit për Trupat e Vlerësimit dhe Subjektet e Vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar”*. Sipas shortit të zhvilluar, Trupa e Vlerësimit përbëhet nga Znj. Loreta Hanxhari (Kryesuese); Znj.Bora Vrenjo (Relatore) dhe Z. Henri Naqellari (Anëtar).
5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë. 28. 02. 2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, vendosi me Vendimin nr.1 datë 04.07.2023, fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Besnik Kongjonaj si dhe të caktojë Kryesues të Trupës Vlerësuese Znj. Loreta Hanxhari.
7. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar të datës 03.08.2023, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar duke i bërë të njohur përbërjen e Trupës së Vlerësimit dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. *** prot. , datë 07.08.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
9. Relatori i çështjes, në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, nenit 4, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 03.08.2023, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
 - nenit 7, pika 7, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 03.08.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 03.08.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
10. Bazuar në nenin 34, pika 3, nenin 42, pika 1 dhe nenin 46, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (në vijim AMP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim DPPSH). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

12. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

13. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar) ka për objekt:

- a) *vlerësimin e pasurisë;*
- b) *kontrollin e figurës;*
- c) *vlerësimin e aftësive profesionale.*

14. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a) Ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b) Ligjin nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- c) Ligjin nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”.
- d) Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.
- e) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm, nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- f) Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar.
- g) Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- *Deklarata e Pasurisë,*
- *Deklarata për Kontrollin e Figurës*
- *Formulari i Vlerësimit Profesional*
- *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*
- *Tri raportet ndihmëse të hartuara nga institucionet shtetërore;*
- *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*
- *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*

- *Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*
15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 12 dhe 14, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
 16. Me subjektin e vlerësimit, është komunikuar me anë të postës elektronike duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave.
 17. Trupa e Vlerësimit, pasi dëgjoi relatimin e bërë nga relatorja e çështjes dhe studioi materialin e përgatitur për këtë qëllim, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatuan se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Besnik Kongjonaj, me Vendimin nr. 2, datë 07.10.2024, vendosi :
 - a) Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Besnik Kongjonaj;
 - b) Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht dhe*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
 - c) Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
 18. Subjekti i vlerësimit, pas njoftimit me e-mail datë 07.10.2024, për përfundimin e procedurave të hetimit administrativ kryesisht dhe dorëzimin e relacionit paraprak të Trupës së Vlerësimit, nuk e ushtroi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Trupa Vlerësuese.

II. SEANCA DËGJIMORE

19. Subjekti i vlerësimit, Brsnik Kongjonaj, u ftua në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 17.10.2024, ora 11:00 në adresën: Salla e Mbledhjeve Kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme.
20. Seanca dëgjimore me subjektin, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën dhe adresën e përcaktuar.

21. Subjekti i vlerësimit, gjatë seancës dëgjimore mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i vlerësimit Bersnik Kongjonaj, kërkoi nga Trupa Vlerësuese konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

22. Subjekti i vlerësimit, Z. Besnik Kongjonaj, ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Trupa Vlerësuese, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Në bazë të nenit 32, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, punonjësi deklaroi çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.
24. Trupa e Vlerësimit ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe fakt, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të, të parashikuar në nenin 31, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
25. Deklarimi i pasurisë nga subjekti kryhet sipas parashikimeve të nenit 32 e 33, ndërsa procedura e vlerësimit të pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar.
26. Sipas kreut III, neni 33/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI-ja bazuar në deklaratimet e pasurisë, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe në përfundim përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.
27. Hetimi administrativ i Trupës Vlerësuese pasi administroi dhe u njoh me Raportin e ILDKPKI-së, konsistoi në:

-verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;

- në verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të deklaruara;

- në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;

- në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

28. Trupa e Vlerësimit për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, ka thelluar hetimin nëpërmjet:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së pasurisë së vlerësimit kalimtar;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhat përkatëse, në raport me të dhënat në deklaratën e vlerësimit kalimtar;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jo financiare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje cash;
- d) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetë deklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar.

29. Trupa e Vlerësimit i ka vlerësuar këto deklarime së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.

30. Subjekti i vlerësimit Z. Besnik Kongjonaj ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion justifikues për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në zbatim të nenit 32, pika 2, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

31. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33/1, pika 3 e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka konstatuar se:

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

Pasuria 1

- Apartament banimi me sip. 51 m², Rruga ***, pallati**, shkalla *, apartamenti *, Tiranë, blerë më 25.07.1994. Certifikatë pronësie datë 17.10.2018, nr pasurie ***. Burimi i krijimit: Përfitur nga ligji nr. 7652 dt. 23.12.1992 për privatizimin e banesave. Vlera 3.864 lekë. Në tetor të vitit 2018, kunata L. Argentieri dhuroi pjesën e saj bashkëshortes sime. Pjesë takuese 50/50%.

DOKUMENTACIONI BASHKËLIDHUR:

- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 17.10.2018, të pasurisë apartament me sip. 51 m2, regjistruar me nr. *** ZK ***, në bashkëpronësi të Besnik Kongjonaj, Sofie Kongjonaj, ndodhur në Rruga ***, pallati ***, Tiranë. Në datë 11.05.2017, pasuria është rivlerësuar në shumën 6.630.000 lekë.
- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 18.04.2018 të pasurisë apartament me sip. 51 m2, regjistruar me nr. *** ZK ***, në bashkëpronësitë Besnik Kongjonaj, L. Argentieri, Sofie Kongjonaj, ndodhur në Rruga ***, pallati ***, Tiranë.
- Kontratë dhurimi nr. ***rep., nr. *** kol., datë 11.10.2018, nënshkruar ndërmjet palës dhuruese L. Argentieri dhe palës pranuese të dhurimit Sofie Kongjonaj, të pjesës takuese 1/3 në apartamentin me sip. 51 m2, regjistruar me nr. *** ZK **, në bashkëpronësi të Besnik Kongjonaj, L. Argentieri, Sofie Kongjonaj. Dhurimi bëhet pa shpërblim dhe pa kusht. B/lidhur ndodhet kartela e pasurisë së paluajtshme dhe harta treguese, dt. 11.10.2018.

HETIMI ADMINISTRATIV

Nga korespondenca me institucionet ligjzbatuese, është administruar dokumentacioni përkatës. Në lidhje me ekzistencën e pasurisë së paluajtshme, nga hetimi administrativ ka rezultuar:

- **ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Veri**, me shkresën nr.***, dt. 6.11.2023 konfirmon pasurinë apartament me sip. 51 m2, në bashkëpronësi të Besnik e Sofie Kongjonaj. B/lidhur..
- Kartela e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 51m2, regjistruar me nr. ***, ZK***, në bashkëpronësi të Besnik Kongjonaj, Sofie Kongjonaj, ndodhur në Rruga *** P. ***, Tiranë.
- Kontratë dhurimi nr. ***rep., nr. ***kol., datë 11.10.2018, nënshkruar ndërmjet palës dhuruese L. Argentieri dhe palës pranuese të dhurimit Sofie Kongjonaj, të pjesës takuese 1/3 në apartamentin me sip. 51 m2, regjistruar me nr. *** ZK ***, në bashkëpronësi të Besnik Kongjonaj, Luiza Argentieri, Sofie Kongjonaj. Dhurimi bëhet pa shpërblim dhe pa kusht.
- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 18.4.2018, të pasurisë apartament me sip. 51 m2, regjistruar me nr. *** ZK ***, në bashkëpronësi të Besnik Kongjonaj, L. Argentieri, Sofie Kongjonaj, ndodhur në Rruga *** P.***, Tiranë.
- **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti sqaroi se apartamenti me sip. 51 m2 në Rr. ***, përfituar në vitin 1994 nga privatizimi, ku L. Argentieri (motra e b/shortes) ka qenë b/pronare. Në vitin 1993 bashkëshortes i është miratuar kërkesa e lejes së banimit në këtë banesë për motrën, e Cila në vitin 2018 i ka kaluar me kontratë dhurimi pjesën e saj, bashkëshortes. Për këtë apartament ka pasur shpenzime mobilimi, të cilat deri në vitin 1997 janë rreth 22.000 lekë, ndërsa nga viti 1997 deri në 2020 rreth 300.000 lekë.

Paraqiti:

- Kontratë shitblerje datë 25.7.1994, palë shitëse Nd. Komunale Banesa dhe palë blerëse Besnik Kongjoni, Sofie Kongjoni e L. Kongjoni, të një apartamenti të ndodhur në Rrugën ***, të përbërë nga 1 dhomë e 1 kuzhinë, me sip. 51 m2, kundrejt shumës 3.864 lekë.
- Vërtetim datë 11.6.1993, nga Bashkia Tiranë, ku sipas së cilës me vendimin nr. 38, datë 30.8.1990, të ish Komitetit Ekzekutiv, për dhënie leje banimi shtetasos Sofie Agron Kongjoni, i është miratuar leje banimi për motrën L. Zotaj, në adresën rruga *** pall. *** ap. *.
- Vendim nr. ***, datë 21.7.2017, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për korrigjim gabimi material të mbiemrit para dhe pas martesës për shtetasen L. Argentieri, për arsye se i është pasqyruar gabim mbiemri para martesës nga Zotaj në Kongjonaj dhe i është pasqyruar gabim mbiemri pas martesës nga Argentieri në Argjenterieri.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

*Pasuria apartament me sip. 51 m2, në rrugën ***, Tiranë, është përfituar në vitin 1994 nga subjekti, bashkëshortja dhe motra e bashkëshortes, me anë të kontratës së privatizimit. Në vitin 2018 motra e bashkëshortes, e cila jeton në Itali, i ka dhuruar subjektit dhe motrës së saj, 1/3 pjesë takuese mbi këtë apartament.*

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.
- ✓ Deklarohen shpenzime mobilimi për apartamentin në vlerën totale prej 322.000 lekë.

Pasuria nr. 2

- Apartament banimi (shtesë anësore) me sip. 57.3 m2 + papafingo me sip. 57.3 m2 (sip. totale 114 m2), Rruga *** P. ***, Sh. *, AP. * Tiranë, ndërtuar në periudhën 1998 - 2012. Deri në vitin 2003, gjysma e shtesës ka qenë e papërfunduar dhe e pabanuar. Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP Tiranë në v. 2016, nr. pasurie *** dhe nr. ***. Burimi i krijimit: të ardhurat nga të ardhurat familjare 1985-2012 dhe huamarrje një personi fizik 500.000 lekë, dt. 28.2.1999 (të deklaruara). Vlera përfërsisht 3.000.000 lekë. Pjesë takuese 100%.

DOKUMENTACIONI BASHKËLIDHUR

- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 28.6.2016, pasurisë apartament, me sip. 57.3 m2, regjistruar me nr. *** ZK ***, në emër të Besnik Kongjonaj.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, dt. 28.6.2016, pasurisë apartament me sip. 57.3 m2, regjistruar me nr. *** ZK ***, në emër të Besnik Kongjonaj.
- Preventiv nga Hamzaj Konstruksion shpk, me përshkrim: shtesë, Rr. *** 53 m2/kati, 4 kate, gjithsej 212 m2, vlerë totale rreth 2.260.000 lekë. Kati i pestë (papafingo), vlerë 498.300 lekë.

- Deklaratë dt. 28.2.1999 e shtetasit K. Zotaj, për dhënien borxh të shumës 500.000 lekë, cash, pa afat.

HETIMI ADMINISTRATIV

- **ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Veri**, me shkresën nr. **, dt. 6.11.2023 konfirmon pasuritë apartament me sip. 57.3 m²/secila, në pronësi të Besnik Kongjonaj. Bashkëlidhur:
- Kartela e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 57.3 m², regjistruar në dt. 16.5.2016 me nr. *** ZK ***, në emër të Besnik Kongjonaj. Pasuria është rivlerësuar në dt. 11.5.2017, në vlerën 7.449.000 lekë, përfituar me leje legalizimi nr.***, dt. 13.09.2013 "apartament në shtesën anësore 4 kate + papafingo.
 - Kartela e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 57.3 m², regjistruar në dt. 16.5.2016, me nr. *** ZK ***, në emër të Besnik Kongjonaj. Pasuria është rivlerësuar në dt. 11.5.2017, në vlerën 7.449.000 lekë, përfituar me leje legalizimi nr. ***, dt. 13.9.2013 "apartament në shtesën anësore 4 kate + papafingo".
- **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti sqaroi se ndërtimi ka filluar nga viti 1998 dhe kanë vazhduar punimet përgjatë viteve, deri në vitin 2012. Janë shpenzuar për shtesën dhe papafingon, për ndërtim karabina shuma 918.300 lekë, punime të brendshme/rikonstruksion shuma 1.256.554 lekë dhe mobilim rreth 800.000 lekë. Shuma totale e Cila përfshin total investimin është rreth 3.000.000 lekë. Burimi financiar i përdorur kanë qenë të ardhurat familjare deri në vitin 2012, si dhe dy huamarrjet e deklaruara në shumën 500.000 lekë dhe 5.000 euro. Përsa i përket shpenzimeve të kryera në lidhje me mobilimin e banesës (shtesë + papafingo), në shumën 800.000 lekë, sqaroi se janë kryer ndër vite, për të cilat nuk disponon fatura pasi ka kaluar kohë e gjatë. Aplikimi për legalizim është bërë në datë 08.04.2006, legalizuar në 10.09.2013 dhe regjistruar në hipotekë në dt. 29.06.2016. Përsa i përket burimit financiar të shtetasit K. Zotaj, sqaroi se është vëllai i b/shortes i cili që nga viti 1997 zhvillon aktivitet farmaceutik. Huaja është marrë prej tij në vitin 1999 dhe është shlyer plotësisht e ndarë në vite. Apartamentet janë banuar gjithmonë nga familja e tij dhe nuk janë dhënë asnjëherë me qira. Përsa i përket burimit financiar të shtetasës Luiza Zotaj, deklaroi se është motra e b/shortes, e Cila është me banim në Itali. Shuma 5.000 euro në vitin 2002, është marrë me qëllim përdorimin e fondeve për kryerjen e punimeve të shtesës së banimit. Si burim financiar nga ana e saj, kanë shërbyer të ardhurat nga shitja në vitin 2001 të një shtëpie në Itali. Paraqiti:
- Leje legalizimi nr.***, datë 10.9.2013, për objektin "apartament në shtesë anësore 4 kat + papafingo " i jepet shtetasit Besnik Kongjonaj. Objekti i regjisruar me nr. ***, me sip. ndërtimi 114.6 m², 4 kate + papafingo.
 - Vetëdeklarim datë 08.04.2006, me subjekt ndërtues "Hamzai Konstruksion", investitorë shtetasit F. Leka, I. Dollaku, Sh. Seiti, B. Kongjonaj.
 - Preventiv oferte nga shoqëria ASI 21 Co shpk, me Objekt "rikonstruksion i brendshëm i apartamentit + papafingo ". Shuma totale 1.256.554 lekë.
 - Licencë nr.***, datë 27.7.2004, për shtetasin R. Tundo, për ushtrimin e profesionit të farmacistit, si drejtues teknik për import-eksport e tregtim me shumicë të barnave në shoqërinë "Zotaj " Vlorë.

- Çertifikatë martese datë 15.3.1995, G. Argentieri dhe L. Zotaj.
- Kontratë shitje datë 07.09.2001, nënshkruar në San Michele Salentino Itali, ndërmjet palës shitëse G. Argentieri e I. Argentieri dhe palës blerëse A. Martinelli, të një banese të ndodhur në San Michele Salentino, kundrejt vlerës 115.000.000 lireta italiane.
- **Bazuar në deklarin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:** Apartamenti (shtesë anësore) me sip. 57.3 m2 + papafingo me sip. 57.3 m2, në rrugën***, është përfituar me anë të vetëdeklarimit për legalizim në vitin 2006, legalizuar në v. 2013, ndërtuar si shtesë anësore + në lartësi, të apartamentit ekzistues të përfituar nga privatizimi (i trajtuar më lart). Referuar deklarin të subjektit dhe dokumentacionit të paraqitur, janë shpenzuar gjithsej për ndërtimin/rikonstruksionin rreth 2.200.000 lekë, si dhe për mobilim shumën 800.000 lekë. Burimi financiar për ndërtimin e objektit, deklarohet në shumën 500.000 lekë, nga huaja e përfituar në vitin 1997, nga vëllai i bashkëshortes, shumën 5.000 euro nga huaja e përfituar në vitin 2002 (deklaruar tek rubrika e detyrimeve financiare) si dhe diferenca nga të ardhurat familjare. Lidhur me mundësitë financiare të huadhënësve, janë paraqitur për vëllain e bashkëshortes, licenca e aktivitetit privat për një farmacistë të kryejë drejtimin teknik të shoqërisë "Zotaj" shpk, në fushën e produkteve farmaceutike, ndërsa për motrën e bashkëshortes, një kontratë shitje pasurie e paluajtshme në vitin 2001 në Itali.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**
- ✓ **Deklarohen shpenzime mobilimi për apartamentin në vlerën totale reth 800.000 lekë, të kryera ndër vite.**

Pasuri e luajtshme Nr. 1

- Automjet Mercedes Benz tip 3001, viti i prodhimit 1991, blerë në vitin 2007, në shumën 100.000 lekë dhe shitur në vitin 2012, në shumën 200.000 lekë.

DOKUMENTACIONI BASHKËLIDHUR:

- Kontratë shitblerje nr. ***rep. nr. *** kol., datë 20.3.2007, nënshkruar ndërmjet palës shitëse E. Caka dhe palës blerëse Besnik Kongjonaj, të automjetit Benz vit prodhimi 1991, me targë TR***J, kundrejt vlerës 100.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitblerje nr. ***rep. nr. *** kol., datë 23.7.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Besnik Kongjonaj dhe palës blerëse K. Hallkaj të automjetit Mercedes Benz, me targë TR***J, kundrejt vlerës 200.000 lekë, shumë e Cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

HETIMI ADMINISTRATIV

- **DPSHTRR** me shkresën nr. ***, dt. 03.10.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Kongjonaj ka patur të regjistruar automjetin me targë AA***ET (referuar përmbajtjes së dosjes, targë TR***J). B/lidhur:
 - Kontratë shitblerje nr. ***rep. nr. ***kol., datë 23.7.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Besnik Kongjonaj dhe palës blerëse K. Hallkaj, të automjetit Mercedes Benz, me targë nr. shasie E*****7, kundrejt vlerës 200.000 lekë, shumë e Cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
 - Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol., datë 20.3.2007, nënshkruar ndërmjet palës shitëse E. Caka dhe palës blerëse Besnik Kongjonaj, të automjetit Benz, vit prodhimi 1991, me targë TR***J, nr. shasie E*****7, kundrejt vlerës 100.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti sqaroi se, automjetit, në momentin para se të shitej, i janë kryer investime dhe rregullime, por nuk disponon faturat pasi ka kaluar kohë dhe nuk janë më në pronësi të tij.
- ✓ **Konstatohet se automjeti Benz, me targë TR***J, është blerë në vitin 2007 dhe shitur në vitin 2012, në vlerën 200.000 lekë, të cilat janë përdorur si burim financiar për blerjen e automjetit tjetër Mercedes Benz në vitin 2012, trajtuar në vijim.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR. Automjeti është shitur.**

Pasuri e luajtshme Nr. 2

- Automjet Mercedes Benz tip 200, viti i prodhimit 2001, blerë në vitin 2012 nga shitja e automjetit të mëparshëm tip 3001) dhe kursime nga të ardhurat familjare 2010-2012, në shumën 500 euro, shitur në 20.6.2016 në shumën 3.200 euro.

DOKUMENTACIONI BASHKËLIDHUR:

- Kontratë shitblerje e pasurisë së luajtshme nr. *** rep. nr. *** kol., datë 20.6.2016, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Besnik Kongjonaj dhe palës blerëse A. Sakaj, të automjetit Daimler Chrysler, me targë AA***GM kundrejt vlerës 3.200 euro, shumë e Cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

HETIMI ADMINISTRATIV

- **DPSHTRR** me shkresën nr. ***, dt. 3.10.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Kongjonaj ka patur të regjistruar automjetin me targë AA***GM.

B/lidhur:

- Kontratë shitblerje e pasurisë së luajtshme nr. *** rep. nr. ***kol. datë 20.6.2016 nënshkruar ndërmjet palës shitëse Besnik Kongjonaj dhe palës blerëse A. Sakaj, të

automjetit Daimler Chrysler, me targë AA***GM, nr. shasie E*****8, kundrejt vlerës 3.200 euro, shumë e Cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

- Leje automjeti, përkthyer nga gjuha gjermane, nga Republika Federale Gjermane për Besnik Kongjonaj, Iloji Daimler Chrysler, nr. shasie E*****8.
- **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti sqaroi se, automjetit, në momentin para se të shitej, i janë kryer investime dhe rregullime, por nuk disponon faturat pasi ka kaluar kohë dhe nuk janë më në pronësi të tij.
- ✓ **Konstatohet se automjeti Benz, me targë AA***GM, deklarohet se është blerë në vitin 2012, në vlerën 500 euro dhe është shitur në vitin 2016, në vlerën 3.200 euro. Nuk është paraqitur dokumentacion nga subjekti dhe nga DPSHTRR për blerjen e automjetit. Të ardhurat nga Shitja e automjetit janë përdorur si burim financiar për blerjen e automjetit tjetër Mercedes Benz, në vitin 2016, trajtuar në vijim.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR, lidhur me shitjen e automjetit. Nuk disponohet/konfirmohet dokumentacioni i blerjes së tij.**

Pasuri e luajtshme nr. 3

- Automjet Mercedes Benz tip 200, viti i prodhimit 2006, blerë më 09.07.2016, nga shitja e automjetit të mëparshëm (3.200 euro), shitur në dt. 16.08.2021, në shumën 600.000 lekë.

DOKUMENTACIONI BASHKËLIDHUR:

- Kontratë shitblerje nr. **** rep nr. ***kol., datë 16.8.2021, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Besnik Kongjonaj dhe palës blerëse F. Rakiplari, të automjetit Daimler Chrysler, me targë AA****4, kundrejt vlerës 600.000 lekë, shumë e cila është likuiduar cash jashtë zyrës noteriale.

HETIMI ADMINISTRATIV

- DPSHTRR me shkresën nr.****, dt. 03.10.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Kongjonaj ka patur të regjistruar automjetin me targë AB***EH. Bashkëlidhur:
- Kontratë shitblerje nr. ***rep nr. *** kol, datë 16.08.2021, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Besnik Kongjonaj dhe palës blerëse F. Rakiplari, të automjetit Daimler Chrysler, me targë AA****M, nr. shasie E*****Z kundrejt vlerës 600.000 lekë, e cila është likuiduar cash jashtë zyrës noteriale.
- Faturë blerje në shtetin gjerman dt. 06.07.2016, përkthyer në gjuhën shqipe, palë blerëse Besnik Kongjonaj të automjetit Daimler Chrysler, nr. shasie E*****7. çmimi i shitjes 2.200 euro.

- Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti sqaroi se, automjetit, në momentin para se të shitej, i janë kryer investime dhe rregullime, por nuk disponon faturat, pasi ka kaluar kohë dhe nuk janë më në pronësi të tij.
- ✓ Konstatohet se automjeti Benz, me targë AA***M (ndryshuar në AB***EH), është blerë në vitin 2016, në vlerën 2.200 euro dhe është shitur në vitin 2016, në vlerën 600.000 lekë. Të ardhurat nga shitja e automjetit, janë përdorur si burim financiar për blerjen e automjetit tjetër Mercedes Benz, në emër të djalit, në vitin 2021, trajtuar në vijim.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTR

Lidhur me detyrimet financiare (tatimin mbi fitim) të diferencës së vlerës së shitjes me atë të blerjes për të gjitha automjetet e deklaruar nga subjekti i vlerësimit dhe trajtuara, Trupa Vlerësuese ka marrë në konsideratë dispozitën e nenit 8 “të ardhura të tatueshme”, të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si edhe udhëzimin Nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku në dispozitën 2.3.9, në të ardhurat “e tjera”, nuk përfshihen të ardhurat nga shitja e paurive të luajtshme. Pavarësisht sa më sipër, Trupa Vlerësuese, ka mbajtur gjithashtu në konsideratë edhe diferencën e vlerave të shitjes dhe blerjes së automjeteve, ku është vërejtur se në të gjitha rastet e trajtuara, nuk ka pasur diferenca të konsiderueshme monetare, për të cilat mund të lindnin dyshime për abuzim.

Likuiditetet:

- Llogari page në RFZ Bank me gjendje në dt. 20.02.2023, në vlerën rreth 34.864 lekë. Pjesë takuese 100%. B/Lidhur:
- Nxjerrje llogarie në emër të Besnik Kongjonaj pranë RFZ Bank, me gjendje në dt.20.02.2023, në vlerën 34.864 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

- **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr.***, dt. 18.09.2023 konfirmon llogarinë e pagës në emër të shtetasit Besnik Kongjonaj dhe gjendjen në llogari dt. 09.03.2023, në vlerën prej 127.680 lekë. Llogaria e lidhur me overdraft limit 200.000 lekë.
- ✓ *Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka, ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në data të ndryshme.*

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Subjekti deklaron:

- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Policisë Fier. Periudha 1.6.2022 - 28.2.2023. Shuma e të ardhurave 1.153.948 lekë.

- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Policisë Tiranë. Periudha 1.4.2018 - 30.5.2022. Shuma e të ardhurave 4.171.539 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Policisë Tiranë. Periudha qershor 2014 mars 2018. Shuma e të ardhurave 3.445.138 lekë.
- Të ardhura nga pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Periudha shtator 2009 - qershor 2014. Shuma e të ardhurave 1.518.155 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në shoqërinë "VLT Albania" Tiranë. Periudha dhjetor 2013 - qershor 2014. Shuma e të ardhurave 357.500 lekë.
- Të ardhura nga pagesa kalimtare (reformë). Periudha shtator 2006 dhe shtator 2009. Shuma e të ardhurave 1.314.000 lekë.
- Të ardhura nga funksioni si specialist në Rep. 73 1, Shkodër. Periudha janar - shtator 2006. Shuma e të ardhurave 476.176 lekë.
- Të ardhura nga qëndrimi në dispozicion për emërim në detyrë tjetër. Periudha nëntor 2004 - janar 2006, me Vendim Gjykate dt. 26.5.2006. Shuma e të ardhurave 927.758 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Policisë Fier. Periudha maj 2003 - nëntor 2004. Shuma e të ardhurave 1.037.737 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Policisë Shkodër. Periudha janar 2002 maj 2003. Shuma e të ardhurave 497.076 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë. Periudha korrik 2001 - dhjetor 2001. Shuma e të ardhurave 183.110 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Komisaratin e Policisë nr.4, Tiranë. Periudha shtator 2000 - janar 2001. Shuma e të ardhurave 121.809 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Komisaratin e Policisë Tepelenë. Periudha nëntor 1999 - gusht 2000. Shuma e të ardhurave 237.470 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Rep. BRISKU Tiranë. Periudha maj 1997 - nëntor 1999. Shuma e të ardhurave 994.450 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Rep. 711, Tiranë. Periudha shtator 1996 - maj 1997. Shuma e të ardhurave 1 16.704 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Policisë Tiranë. Periudha nëntor 1995 shtator 1996 dhe shtator 2000 - dhjetor 2000. Shuma e të ardhurave 190.661 lekë.
- Të ardhura si pedagog në akademinë e sigurisë. Periudha janar 1991 - nëntor 1991. Shuma e të ardhurave 12.196 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Ministrinë e Brendshme. Periudha janar - qershor 2001. Shuma e të ardhurave 336.519 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e FSH - MRP. Periudha 1.8.1993 - 15.11.1995. Shuma e të ardhurave 236.391 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Rendit-MRP. Periudha 16.1.1992 31.7.1993. Shuma e të ardhurave 54.800 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Policisë Tiranë. Periudha dljetor 1991 janar 1992. Shuma e të ardhurave 1.908 lekë.

- Të ardhura si pedagog në shkollën e MPB Tiranë. Periudha 1.9.1985 - 30.II.1991. Shuma e të ardhurave 65.316 lekë.
- Të ardhura nga shitja e automjetit Mercedes Benz dt. 16.8.2021. Shuma 600.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e automjetit Mercedes Benz dt. 20.6.2016. Shuma 3.200 euro.
- Të ardhura nga shitja e automjetit Mercedes Benz dt. 23.7.2012. Shuma 200.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e automjetit Mercedes Benz në vitin 1999. Shuma 300.000 lekë.

DOKUMENTACIONI BASHKËLIDHUR

- Vërtetim datë 03.03.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës l. 6.2022 - 28.2.2023, në shumën totale l. 153.948 lekë.
- Vërtetim nga Instituti i Përgatitjes së Qenve të Policisë, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës 01.04.2018 - 30.05.2022, në shumën totale 4.171.539 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., dt. 19.4.2018, nga Instituti i Përgatitjes së Qenve të Policisë, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës qershor 2014 - mars 2018, në shumën totale 3.445.138 lekë.
- Vërtetim nr. **** prot., dt. 23.4.2018, nga DRSSH Tiranë, për Besnik Kongjonaj, i cili trajtohet me pension policie. Të ardhurat totale të përfituara nga Sigurimet Shoqërore janë 1.518.155 lekë.
- Vërtetim datë 30.4.2018 nga shoqëria VLT Albania për shtetasin Besnik Kongjonaj, i cili ka qenë i punësuar gjatë periudhës 11.12.2013 - 27.6.2014, me pagë neto mujore rreth 55.000 lekë (gjithsej rreth 350.000 lekë).
- Vërtetim nga Reparti NSH Shkodër, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, i cili gjatë periudhës tetor 2006 - shtator 2009 ka përfutuar nga reforma, shumën totale rreth 1.314.000 lekë.
- Vërtetim nga Reparti NSH Shkodër, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës janar - shtator 2006, në shumën totale 476.176 lekë.
- Vërtetim nr. Extra prot., datë 27.3.2018, nga Reparti NSH Shkodër, për shtetasin Besnik Kongjonaj, i cili me Vendimin e Gjykatës nr. akti 3993, dl. 26.5.2006, gjatë periudhës 28.11.2004 – 15.01.2006 është trajtuar me pagë neto, në shumën totale 927.758 lekë. B/lidhur vendimi i gjykatës nr. ***; nr. akti ****, dt. 26.05.2006.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës 5.5.2003 - 27.11.2004, në shumën totale 1.038.000 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot, datë 20.1.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës janar 2002 - maj 2003, në shumën totale 497.076 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës korrik 2001 - dhjetor 2001, në shumën totale 183.110 lekë.

- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës shtator dhjetor 2000, në shumën totale 121.800 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës dhjetor 1999 - shtator 2000, në shumën totale 237.470 lekë.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 3.4.2018, nga Reparti Special "Resi ", për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës qershor 1997 dhjetor 1999, në shumën totale 1.029.808 lekë.
- Vërtetim nga Reparti NSH Tiranë, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës shtator 1996 - maj 1997, në shumën totale 116.704 lekë.
- Vërtetim nr. **** prot., datë 23.4.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës 16.11.1995-16.9.1996 dhe 1.9.2000 - 31.12.2000, në shumën totale 190.661 lekë.
- Vërtetim nga Ministria e Brendshme, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës janar 1994 - nëntor 1995 dhe janar - qershor 2001, në shumën totale 336.519 lekë.
- Vërtetim nr. 3/1 prot., datë 17.4.2018, nga Akademia e Sigurisë Tiranë, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Besnik Kongjonaj, gjatë periudhës l. 1.1991 30.11.1991, në shumën totale 12.196 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

- Raiffeisen Bank me shkresën nr. 70/2, dt. 26.9.2023, konfirmon Ilogari page në emër të shtetasit Besnik Kongjonaj dhe pagat e kreditura gjatë periudhës 3.2.2006 - 6.7.2009, në vlerën totale rreth 3.250.000 lekë (përfshirë shuma e kredituar në dt. 27.12.2006 nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. 3006, dt. 26.6.2005), si dhe gjatë periudhës 2.7.2014 - 3.8.2023, në vlerën totale rreth 9.465.000 lekë.
- Vërtetim nga subjekti "Save the Children " për Ardita Kongjonaj, e Cila ka realizuar të ardhura gjatë periudhës së punësimit 06.01.2014 - 18.04.2017, në shumën totale prej 4.046.874 lekë.
- Kontratë pune, nënshkruar ne dt. 01.11.2021 ndërmjet punëdhënësit Qendra Plan&Go dhe punëmarrësit Ardita Kongjonaj, për periudhën deri në dt. 30.04.2022. Vlera kontratës 1.278 euro/muaj.
- Kontratë pune, nënshkruar në dt. 04.05.2022 ndërmjet punëdhënësit Qendra Plan&Go dhe punëmarrësit Ardita Kongjonaj, për periudhën deri në dt. 31.05.2022. Vlera e kontratës 1.278 euro/muaj.
- Vërtetim nr. **** prot., datë 08.03.2023, nga Qendra e Shërbimeve Arsimore për Ardita Kongjonaj, e Cila ka realizuar të ardhura gjatë periudhës së punësimit 19.09.2011 - 31.12.2012, në shumën totale prej 521.264 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., dt. 24.04.2018, nga Credins Bank për Ardita Kongjonaj dhe veprimet e kryera prej saj (të ardhura - shpenzime) si kliente e bankës.

HETIMI ADMINISTRATIV

- **RFZ Bank** me shkresën nr. *** prot., dt. 18.09.2023, konfirmon të ardhurat e realizuara nga shtetasja Ardita Kongjonaj, gjatë periudhës 31.01.2014 -28.4.2017, në shumën 4.120.876 lekë (4.096.000 lekë nga Save the Children + 25.000 lekë nga Terre Des Hommes Shqipëri); janar 2018 - mars 2023, në shumën 7.140.000 lekë (përfshirë transfertën bankare dt. 7.10.2021, ku është kredituar shuma 592.500 lekë nga Israel Forum; transfertat bankare nga Qendra Plan e Go, gjatë periudhës dhjetor 2021 - qershor 2022, në total 700.740 lekë). Në Ilogarinë EUR evidentohet kreditimi në dt. 6.1.2020, i shumës 839 euro, nga The Hebreë University of Jerusalem.
- **Intesa Sanpaolo Bank** me shkresën nr.***, dt. 26.09.2023, konfirmon se shtetasja Ardita Kongjonaj ka patur Ilogari aktive gjatë periudhës 2019 - 2020, aktualisht e mbyllur.

Evidentohet kreditimi i pagave nga Agro Iliria Group shpk . (referuar përshkrimit, pagat maj - tetor 2019, sipas kontratës së shërbimit), në vlerën totale rreth 243.000 lekë.

- **Credins Bank** me shkresën nr. **** prot., dt. 25.09.2023, konfirmon Ilogari page në emër të Ardita Kongjonaj dhe të ardhurat e kredituara për periudhën 23.04.2009 -02.07.2009, bursë nga Fakulteli i Mjekësisë, në vlerën totale prej 51.000 lekë; 18.10.2011 – 17. 12. 2012, nga Agjensia Kombëtare e Provimeve, në vlerën totale rreth 526.000 lekë. Në Ilogarinë euro transferohen fonde nga Hellgrupet Samit, për vitin 2014 në total 2.534 euro, në 2015 vlera 3.260 euro, në 2016 vlera rreth 1.300 euro, në 2017 vlera 298 euro + 522 euro, nga Stifng Mercator GmbH.
- **ISSH** me shkresën nr. **** prot., datë 19.09.2023, konfirmon se Ardita Kongjonaj ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: janar 2012 - gusht 2013, pranë Agjensisë Kombëtare të Provimeve; janar 2014 -prill 2017, Fond. "Save the Children", dhjetor 2017 - gusht 2023, pranë Agjencisë Për Dialog dhe Bashkëqeverisje, maj - qershor 2019 pranë Agro Iliria Group; dhjetor 2021 maj 2022, pranë Qendrës Plan & Go.
- **Të ardhurat e vajzës nga paga, bursat dhe kontratat e shërbimeve, për periudhën tetor 2011 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 12.100.000 lekë + 7.900 euro, konvertuar gjithsej rreth 13.000.000 lekë.**

❖ **Gjithashtu, nga hetimi administrativ, ka rezultuar se:**

- **RFZ Bank** me shkresën nr. *** prot., dt. 18.09.2023 konfirmon se shtetasja Ardita Kongjonaj zotëron Ilogari ALL/EUR në të cilën evidentohen transaksionet:

Kongjonaj zotëron Ilogari ALL/EUR në të cilën evidentohen transaksionet:

Në Ilogarinë EUR: depozitime cash të kryera nga Ardita Kongjonaj në dy Ilogaritë EUR (në bankë ose cashin në bankomat), për vitin 2017 në shumën 6.842; për vitin 2018 në shumën 9.010 euro; për vitin 2019 në shumën 14.106 euro; për vitin 2020 shumën 4.640 euro; për vitin 2021 shumën 21.557 euro; për vitin 2022 shumën 27.405 euro.

- **Me inventarin e datës 13.12.2023** dhe proces verbalin e datës 23.01.2024, subjekti sqaroi se fondet e depozituara nga vajza e ne RFZ Bank, janë nga kursimet dhe të ardhurat e saj nga pagat, nga viti 2011 dhe në vazhdim, pa shkëputje nga puna. Kursimet e saj i ka depozituar sipas nevojës, në Ilogarinë në euro, për të kryer shpenzime me kartë për facilitet. Shumat nuk janë depozituar njëherësh, por është e njëjta shumë e Cila është kredituar e debituar sipas nevojave dhe nuk duhet të kuptohet që kreditimi është domosdoshmërisht një hyrje e re. Ardita e tërheq rrogën cash çdo fillim muaji të cilën sipas nevojave e konverton në valutë dhe kryer transaksione kur i nevojiten, në debitim apo kreditim në Ilogarinë Euro në RFZ Bank. Vlerat që ka arritur depozita e Ardites, janë të gjitha kursimet ndër vite të rrogave dhe projekteve të realizuara si dhe punëve vullnetare me organizma të ndryshëm. Ajo banon me prindërit dhe me të ardhurat e saj, ka çelur Ilogarinë, ka mbuluar

shpenzimet personale të udhëtimeve dhe i ka mbetur gjendje shuma e deklaruar në Ilogari. Në kushtet e bashkëjetesës familjare, ai dhe bashkëshortja kanë pasur kontribut financiar të përbashkët në shpenzimet e vajzës së tyre. Në vitet e para të punësimit, ka kontribuar për shpenzimet familjare për jetesë.

- **Në Ilogarinë bankare në euro, të vajzës së subjektit, Znj. Ardita Kongjonaj, evidentohet se shumat e derdhura ndër vite janë kryer të pjesshme, në shumat të ndryshme.**
- **Subjekti dha sqarime lidhur me transaksionet financiare të vajzës pranë RFZ Bank tllhe burimin financiar.**

✚ **ABI Bank** me shkresën nr. *** prot., dt. 26.09.2023 konfirmon se shtetasja Sofie Kongjonaj rezulton të ketë qenë garantore në kredinë e shtetasit F. Baroni, marrë më dt. 04.05.2017 në shumën 500.000 lekë, afat maturimi 15.08.2008. B/lidhur Ilogaria bankare e shtetasit F. Baroni.

- **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti sqaroi se bashkëshortja ka dalë si garantore në vitin 2007, në kredinë e shtetasve F. Baroni dhe E. Baroni, ku kjo e fundit ka qenë kolege e punës së bashkëshortes në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Në vitin 2008 kjo kredi rezulton e mbyllur. Paraqiti: Vërtetim bankar nga ABI Bank, për F. Baroni dhe E. Emiri (Baroni), të cilët më datë 04.05.2007 kanë marrë një kredi me vlerë 500.000 lekë dhe më datë 15.08.2008 e kanë mbyllur.

Subjekti dha sqarime lidhur me konfirmimin e Abi Bank

✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. **** prot., dt. 25.09.2023, konfirmon Ilogari në emër të shtetasit Besnik Kongjonaj, aktive për vitin 2007, në të cilën në dt. 19.03.2007 ka depozituar shumën 300.000 lekë dhe në dt. 27.09.2007 e ka transferuar në favor të Sofie Kongjonaj.

✚ Gjithashtu, në emër të Sofie Kongjonaj konfirmohet se: Ka patur Ilogari në të cilën në dt. 20.10.2006 është disbursuar një kredi me vlerë 500.000 lekë, tërhequr cash në dt. 17.11.2006, shlyer totalisht në dt. 11.04.2007 dhe në dt. 22.12.2014 është disbursuar një kredi me vlerë 240.000 lekë, transferuar në favor të Emigres shpk, kalim për likuidim faturë dt. 19.12.2014. Shlyer totalisht në dt.22.06.2016. Në dt. 20.01.2006 çel depozitë në vlerën 1.050.000 lekë (arkëtim) dhe në dt. 21.7.2007 e tërheq vlerën cash. Në dt. 07.04.2006 çel depozitë në vlerën 1.250.000 lekë (arkëtim) dhe në dt. 09.07.2007 e tërheq vlerën cash.

- **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti sqaroi se qëllimi i marrjes së kredisë në vitin 2006 pranë Credins Bank, në shumën 500.000 lekë ka qenë për shpenzime të kryera në shtesat e apartamenteve të specifikuar edhe tek preventivi. Kredia është shlyer gjatë vitit 2007. Kredia në shumën 240.000 lekë, në vitin 2014 është marrë për blerje mobileri, shumë e Cila i ka kaluar shoqërisë Emigres në datë 09.12.2014. Gjithashtu sqaroi se destinacioni i përdorimit të fondeve të tërhequra prej tij në vitin 2007 është përdorur në vazhdimësi për punimet e brendshme dhe mobilimin e shtesës, për të cilën është aplikuar për legalizim banese, në vitin 2006. Burimi financiar i kreditimeve në Ilogarinë time në Bankën Credins në vitin 2006, në shumat 1.050.000 lekë dhe 1.250.000 lekë janë nga kursimet familjare dhe huamarrjet e deklaruara me qëllim për t'u përdorur për përfundimin e punimeve në shtesën në apartamentin ekzistues.

➤ **Subjekti dha sqarime lidhur me transaksionet financiare familjare pranë Credins Bank.**

✚ **OTP Bank**, me shkresën nr. *** prot., dt. 18.09.2023, konfirmon se shtetasi Antonio Kongjonaj ka pasur Ilogari, e Cila sipas dokumentacionit b/lidhur, ka qenë aktive gjatë vitit 2011. Në dt. 20.9.2011 ka depozituar shumën 1.000 euro, vlerë e Cila është tërhequr cash në dt. 28.10.2011.

✚ **Unioni Financiar**, me shkresën nr.***, dt. 21.09.2023, konfirmon për shtetasit: Sofie Kongjonaj, 3 transaksione në mbërritje, me vlerë 800 euro; Ardita Kongjonaj, 3 transaksione në mbërritje, me vlerë 960 euro; Antonio Kongjonaj, 3 transaksione në mbërritje, me vlerë 600 euro.

➤ **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti sqaroi se transaksionet e mbërritura në favor të bashkëshortes 800 euro me Ëestern Union kanë patur si prejardhje shumën 700 euro të dërguar nga djali Antonio Kongjonaj dhe 100 euro nga S. Rakipaj (djali i motrës së b/shortes). Gjithashtu fondet e mbërritura me vlerë 960 euro kanë si prejardhje shumën 760 euro të dërguar nga djali Antonio Kongjonaj dhe 200 euro dhuratë nga një mik i Israelit, M. Gold. Transaksionet në mbërritje me vlerë 600 euro në favor të djalit Antonio Kongjonaj janë dërguar prej tij në Ilogarinë e tij në Shqipëri.

✚ **AK Invest** me shkresën nr.***, dt. 20.09.2023, konfirmon se shtetasja Ardita Kongjonaj ka patur një transaksion si dërguese, në favor të D. Laëson, dt. 20.08. 2011, vlera 290 euro.

➤ **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti paraqiti një komunikim me postë elektronike në të cilën evidentohet kryerja e pagesës në favor të David Laëson.

✓ **Subjekti paraqiti dokumentacion lidhur me konfirmimin e AK Invest.**

✚ **RFZ Bank**, me shkresën nr. *** prot., dt. 18.09.2023, konfirmon veprime bankare ku rezulton se Ardita Kongjonaj ka likuiduar gjoba automjetesh, të cilat nuk figurojnë në emër të saj, konkretisht për automjetet AB***BO; AB***BN dhe AB***EH.

➤ **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti sqaroi se asnjë nga automjetet nuk është në pronësi të vajzës. Vajza ka kryer pagesa gjobash për facilitet kohe nëpërmjet aplikacionit të bankës.

➤ **Me inventarin e datës 19.12.2023** subjekti paraqiti:

- Autorizim datë 13.12.2023, nga Albania Car Rentals, për shtetasen Ardita Kongjonaj, e cila ka pasur me qira për periudhën janar 2022 - mars 2022, automjetin tip Volksäagen Jetta, me targë AB***BN, me periudha të shkëputura, tre-shtatë ditore.
- Deklaratë e shtetasit Antonio Kongjonaj, i cili deklaroi se motra Ardita Kongjonaj ka kryer pagesa të gjobave të automjetit të tij, me targë AB***EH.
- Vërtetim datë 15.12.2023, nga subjekti "Agro Iliria Group " për automjetin me targë AB***BO, i cili është në pronësi të kësaj shoqërie. Shtetasja Ardita Kongjonaj, ka kryer pagesë në ndihmë të shoqërisë për arsye lehtësimi procedure.

➤ **Me proces verbalin e datës 19.12.2023**, subjekti sqaroi se vajza e tij ka punuar një periudhë kohe për kompaninë "Agro Iliria Group " dhe kanë ruajtur raporte të mira e korrekte, herë pas here në kushtet kur ka pasur nevojë për të lëvizur, për udhëtime brenda apo jashtë qytetit, i ka kërkuar mjetin kësaj kompanie, pa kontribute financiare. Njëkohësisht fakti që ajo ka paguar gjokat e kompanisë, jo domosdoshmërisht ka qenë për shkak të përdorimit të mjetit në atë moment.

✓ **Subjekti dha sqarime lidhur me konfirmimet e DPSHTRR dhe RFZ Bank.**

✚ **QKB**, me shkresën nr. 70/28 prot., datë 18.9.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Kongjonaj dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT) si persona fizikë apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.

✚ **DPT, Dreitoria Raionale Tatimore Durrës**, me shkresën nr. 70/29 prot., datë 18.9.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Kongjonaj figuron i regjistruar si administrator i shoqërisë "Rexha-Security" shpk, me NIPT 1948302010, me vendndodhje në Krujë dhe me status "pasiv" prej datës 8.9.2011.

➤ **Me inventarin e datës 13.12.2023** subjekti sqaroi se është emëruar administrator në këtë shoqëri, por nuk e ka ushtruar asnjëherë detyrën nga data e regjistrimit të këtij aktiviteti deri kur ka kaluar në status pasiv.

✚ **Nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore e Cështjeve të Drejtësisë, Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale**, Trupa Vlerësuese, vihet në dijeni mbi një deklaratë noteriale të nënshkruar përpara Noteres Vjollca Skendo me Nr. *** Rep. dhe Nr. *** Kol, me palë, shtetasen J. Hito dhe Znj. Ardita Kongjonaj (Vajza e Subjektit). Në përmbajtje të kësaj deklarate është shprehur:

*“... Unë deklaroj se J. Hito i detyrohem zonjës Ardita Kongjonaj për shumën 70.000 euro (shtatëdhjetëmijë). Këtë shumë ja kam marrë për të bërë rikonstruksionin e katit të gjashtë të banimit të shtëpisë që ndodhet në Tiranë në adresën rruga “*****”, pall *** ap **, banesë e cila është në pronësi të babait tim Pëllumb Hito. Një kopje e certifikatës së pronësisë së apartamentit do ti bashkëngjitet kësaj deklarate. Këtë shumë ja kam marrë pa interes dhe do tja kthej tërësisht më 30 qershor 2015.*

Deklaruesja Ardita Kongjonaj deklaroi se është dakord sa më sipër dhe nuk ka asnjë pretendim...”

➤ **Në shkresën “Kthim përgjigje” me nr. *** datë 07.06.2024**, subjekti sqaron se: “...data e dhënies hua të shumës 70.000 euro është 10.06.2015. Shuma është marrë nga kushëriri i Ardites, Z. Enrik Zotaj, Administrator i kompanisë “Avicena” në atë periudhë, Shuma është dhënë dhe është marrë para në dorë kesh. Shuma është kthyer në 30.06.2015 dhe menjëherë i është kthyer Z. Enrik Zotaj. Deklarata e kontrollit të pasurisë përfshin shumë vite dhe për të kryer deklarim sa më të saktë, e për të mos harruar asnjë lëvizje financiare, i jemi referuar shpesh dokumenteve të shkuara. Në lidhje me huamarrjen në fjalë nuk e kemi

dokumentin noterial, e meqënëse ka kaluar gati një dekadë dhe huaja është shlyer brenda 20 ditëve, Ardita nuk është kujtuar për këtë fakt...”. Bashkëlidhur:

- Deklaratë Enrik Zotaj
- **Në shkresën “Kthim përgjigje” me nr. *****, datë 25.06.2024**, subjekti sqaron se “...shtetasja J. Hito, në vitin 2015 kishte aplikuar për një kredi të cilës i duhej për rikonstruksion banese dhe shlyerje të disa huamarrjeve personale të saj. Shuma 70.000 euro, u sigurua nga banka Credins, me kontratën e kredisë afat gjatë nr. ***** repertor, nr. *** koleksion, datë 10.06.2015, për shlyerje detyrimi dhe rikonstruksion banese. Kthimi brenda harkut kohor prej 20 ditësh, u sigurua duke qenë se kishin filluar bisedimet me bankën për aprovimin dhe lëvrimin e kredisë. Duke qenë se nuk ishte e sigurtë për datën e aprovimit të kredisë dhe kishte afate për shpenzimet dhe detyrimet e bëra i kërkoi mikes së saj, Znj. Ardita Kongjonaj, t’i jepte hua, për t’ja kthyer në një afat të shkurtër . Gjithmonë duke u bazuar te aprovimi dhe lëvrimi i kredisë. Atë ditë që u aprovua kredia ishin marrë dhe hua shuma te znj. Ardita Kongjonaj. Kjo shumë ju kthye brenda afatit 20 ditore. Në lidhje me kërkesën e dytë për preventivin dhe faturat e rikonstruksionit, shtetasja Joniada Hito deklaroi se nuk i disponon...”. Bashkëlidhur:
- Ekstrakti historik i shoqërisë “Avicena”, bilancet e viteve 2014-2016, në të cilat evidentohet se në vitin 2015, subjekti Avicena Sh.p.k ka gjeneruar të ardhura në vlerën 211.386.545 Lekë.
- Dokument me veprime bankare të shtetasës J. Hito ku pasqyrohet disbuirsimi i kredisë bankare sipas deklaramit dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti.
- **Në shkresën “Kthim përgjigje”, me Nr. ***** prot, datë 18.07.2024**, subjekti sqaron se: “...sipas bilanceve marrë nga QKB , shoqëria “Avicena “, në 2015 nuk ka shpërndarë dividend, por sjellim në vëmendjen tuaj se të ardhurat e shoqërisë për vitin 2015 kanë qenë rreth 1.5 milion euro edhe pse në mbylljen e vitit 2015 shoqëria ka dalë me humbje. Sipas dokumentacionit të dorëzuar më parë (deklarata e dhënë nga Z. Enrik Zotaj), të cilën e gjeni të noterizuar bashkëlidhur , personi tregon se shuma 70.000 euro është marrë nga xhiroja e shoqërisë, të cilat ndahen dhe përllogariten për periudhën e një viti dhe pasi viti ka përfunduar. Kjo shumë është marrë borxh për një periudhë 20 ditore në qershor të vitit 2015 dhe është kthyer brenda periudhës së rënë dakord”. Bashkëlidhur:
- Deklaratë noteriale me Nr. Repertori ***, Nr. Koleksioni ***, datë 15.07.2024 e shtetasve Enrik Zotaj dhe Ardita Kongjonaj në të cilën deklarohet:

“..Unë, Enrik Zotaj deklaroj me përgjegjësi të plotë ligjore se i kam dhënë kushërirës sime Ardita Kongjonaj shumën prej 70.000 Euro (shtatëdhjetë mijë) kesh, më datë 10.06.2015. Arsyeja e dhënies së kësaj shume ishte për të ndihmuar shoqen e saj Joniada Hito. Ardita Kongjonaj ka shërbyer si garantore, ma ka kërkuar këtë shumë rreth dy javë përpara dhënies së shumës. Kthimi i shumës borxh nga Ardita Kongjonaj tek unë është kryer brenda 20 ditëve kesh, datë 30.06.2015 pa interes. Borxhi është dhënë me mirëbesim të

plotë, dhe unë deklaroj se këto të ardhura janë nga xhiroja e kompanisë farmaceutike Avicena në cilësinë time të plotë si administrator...”

- Dokument i veprimeve bankare në llogarinë e shtetases J. Hito, pas lëvrimit të kredisë.

Qëndrimi i Trupës Vlerësuese:

Sa më sipër, Trupa Vlerësuese, pasi ka kryer një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës si edhe ka kërkuar disa herë shpjegime nga subjekti mbi burimin e krijimit të shumës së konsiderueshme prej 70.000 euro dhënë hua nga personi i lidhur i subjektit të vlerësimit, vajza e tij, Znj Ardita Kongjonaj shtetases J. Hito, arrin në përfundimin se:

Personi i lidhur i subjektit, Znj. Ardita Kongjonaj, ka këkuar nga shtetasi Enrik Zotaj (i afërmi i saj), shumën monetare 70.000 euro në periudhën maj-qershor 2015, e cila do ti jepej hua mikes së saj, shtetases J. Hito për një periudhë 20 ditore deri në disbursimin e kredisë bankare, për të cilën shtetasja J. Hito kishte aplikuar , ashtu siç paraqitet edhe në dokumentacionin e dorëzuar dhe deklaratën noteriale. Shuma monetare 70.000 euro, ka si burim të ardhurat e subjektit “Avicena” shpk, me administrator në periudhën e dhënies së huasë, shtetasin Z. Enrik Zotaj dhe ortak të vetëm Kastriot Zotaj, tashmë i ndjerë (i ati) i Z. Enrik Zotaj. Për shkak të lidhjeve të ngushta familjare dhe faktit që shuma do të kthehej brenda 20 ditëve, ashtu siç është sanksionuar edhe në deklaratën noteriale të nënshkruar nga Znj. Ardita Kongjonaj dhe Znj. J. Hito, nuk është mbajtur dokumentacion shkresor mbi dhënien hua dhe kthimin e shumës monetare. Subjekti, ka paraqitur dokumentacion justifikues, në të cilin evidentohet se subjekti “Avicena” shpk në periudhën e dhënies hua të shumës monetare, ka pasur të ardhura të mjaftueshme në vlerën 211.386.545 Lekë, sipas pasqyrës financiare të performancës (të ardhura-shpenzime).

Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar deri në datë 09.03.2023, si më poshtë:

1. Apartament banimi me sip. 51 m2, rruga e Barrikadave, Tiranë. Vlerë 3.864 lekë. Zotëron 100% me bashkëshorten.
2. Apartament banimi (shtesë anësore) me sip. 57.3 m2 + papafingo me sip. 57.3 m2 (sip. totale 114 m2), rruga e Barikadave, Tiranë. Vlerë rreth 3.000.000 lekë. Zotëron 100% me bashkëshorten.
3. Llogari page në RFZ Bank. Vierë 34.864 lekë. Zotëron 100%.
4. B/shortja: Llogari page në BKT. Vlerë 34.446 lekë. Zotëron 100%.
5. B/shortja: Depozitë në Credins Bank. Vlerë 175.745 lekë. Zotëron 100%.
6. Djali: Automjet Mercedes Benz. Vlerë 1.216.000 lekë. Zotëron 100%.
7. Djali: Llogari bankare në OP Finlandë. Vlerë 2.075 euro. Zotëron 100%.
8. Djali: Llogari bankare në OP Finlandë. Vlerë 5.000 euro. Zotëron 100%.
9. Djali: Llogari bankare në OP Finlandë. Vlerë 79 euro. Zotëron 100%.
10. Djali: Llogari bankare në RFZ Bank. Vlerë 0 lekë. Zotëron 100%.
11. Vajza: Llogari page në RFZ Bank. Vlerë 23.931 lekë. Zotëron 100%.
12. Vajza: Llogari page në RFZ Bank. Vlerë 23.478 euro. Zotëron 100%.
13. Vajza: Kartë krediti në RFZ Bank. Vlerë 1.047 euro. Zotëron 100%.

14. Detyrim financiar ndaj shtetases Luiza Argentieri. Vlerë 3.000 euro. Zotëron 100%.

Vlera e pasurisë bruto është 4.488.850 lekë + 30.632 Euro, e konvertuar rreth 8.113.000 dhe neto rreth 7.650.000 lekë.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- ✓ ***Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 09.03.2023, është deklaruar 4.488.850 lekë + 30.632 Euro e konvertuar bruto rreth 8.113.000 dhe neto rreth 7.650.000 lekë.***
- ✓ Të ardhurat neto të subjektit nga paga, shpërblimet dhe vendimi i gjykatës, për periudhën 1985 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 18.357.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat neto të bashkëshortes nga paga, shpërblimet, për periudhën 1993 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 17.640.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e djalit nga pagat në Finlandë, për periudhën qershor 2018 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 101.740 euro, konvertuar gjithsej rreth 11.639.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e vajzës nga paga, bursat dhe kontratat e shërbimeve, për periudhën tetor 2011 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 12.100.000 lekë + 7.900 euro, konvertuar gjithsej rreth 13.000.000 lekë.

Giithashtu, janë deklaruar:

- ✓ Huamarrje në vitet 2002/2015, shtetases L. Argentieri (Zotaj), për ndërtimin e shtesës së apartamentit në Tiranë dhe shlyerje kredie, në shumën 8.000 euro. Detyrimi i mbetur 3.000 euro.
- ✓ Huamarrje në v. 1999, shtetasit K. Zotaj, për ndërtimin e shtesës së apartamentit në Tiranë. Shuma 500.000 lekë. Shlyer.
- ✓ Kredi në Credins Bank në vitin 2015, në vlerën 241.000 lekë. Shlyer.
- ✓ Kredi në Raiffeisen Bank, në vitin 2017 në vlerën 720.000 lekë. Shlyer.
- ✓ ***Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:***
 - a) ***deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;***
 - b) ***nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;***
 - c) ***nuk është kryer fshehje e pasurisë;***
 - ç) ***nuk është kryer deklarim i rremë;***

d) punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit

B. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërma (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ **TRUPA E VLERËSIMIT**, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit Z. Besnik Kongjonaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës, TRUPA E VLERËSIMIT administroi:**


- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”.
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet ligjzbatuese.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, rezulton se:

- **Nuk ka** ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit.
- Subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të dënuar.
- **Nuk ka** të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtëpërdrejtë ose indirect në veprime të dyshimta.
- **Nuk ka** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe

funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.

- **Nuk ka** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të denuar apo proceduar penalisht, Brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192 datë 30.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar).
- **Nuk ka** të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.
- **Nuk ka** të dhëna nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.
- **Nuk ka** të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerje e një vepre penale.
- **Nuk ka** të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- **Nuk ka** të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm
- **Nuk ka** procedime penale të referuara
- Për subjektin e vlerësimit **nuk disponohen** ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.
- **Nuk është** nxjerë urdhër ndalimi
- **Nuk është** kërkuar masë e sigurimit personal
- **Nuk është** marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit në hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale
- **Nuk ka pasur** regjistrim të njoftimit të veprave penale
- **Nuk ka pasur** raste të urdhrave ndërkombëtare të ndalimit.
- **Nuk rezulton** të jetë regjistruar ndonjë procedim penal për subjektin apo personat e lidhur me të.
- Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”, me datë lëshimi 19.11.2021, të vlefshme deri më datë 18.05.2026. për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera.
- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
- Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri më 2 Korrik 1991.

 **Testi** për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimit **Z Besnik Çerçiz Kongjonaj**:

Në përfundim të testit, sipas ekzaminimit toksikologjiko-ligjor nr. **** të ardhur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me shkresë nr. *** prot., datë 05.12.2023, jemi bërë me dije se:

“Në mostrën e marrë subjektit **nuk u zbulua** prania e produkteve të lëndëve narkotike të grupit të MOP (opiate/heroinë), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (triciklike antidepressante), AMP (amphetamine), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepine).

✓ *Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3 të nenit 42 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*

a) punonjësi nuk ka kryer deklaram të rremë;

b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;

c) nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit **Z. Besnik Kongjonaj** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Zëvendës drejtor për Sigurinë Publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, sipas Urdhërit Nr. 1196, datë 21.06.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

✚ Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 2 dhe 3 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit me Nr. 12670;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, sistemi RMIS, me Nr. RMIS 9001295;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të Nenit 44, pika 1, Ligjit Nr. 12/2018 , i ndryshuar, të mbështetur në dokumentacionin shoqëruar.
- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e subjektit.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i të burimeve të mësipërme, konstatohet si më poshtë vijon:

✚ TË DHËNA MBI ARSIMIMIN

- Ka përfunduar arsimin e lartë në shkollën e Lartë të Bashkuar, në periudhën 1982-1985, dhe Institutin e Lartë të Rendit në periudhën 1990-1992.
- ✓ *Sa më sipër, subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që kryen, sipas përcaktimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.*

✚ TRAJNIMET DHE KUALIFIKIMET

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se ka kryer trajnimet dhe specializimet si më poshtë:

- Viti 2002, “Trajnim i trajnerëve të policisë”, pajisur me Certifikatë;
- Viti 2003, “Program për hetimin e krimit ndërkombëtar”, pajisur me Certifikatë;
- Viti 2007, “Krimi i organizuar dhe lufta kundër narkotikëve”, pajisur me Certifikatë;
- Viti 2008, “Roli i policisë në legjislacionin kundër narkotikëve”, pajisur me Certifikatë.

Gjithashtu, gjatë karrierës rezulton se subjekti ka marrë Certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave e konkretisht:

- Viti 2016, Certifikatë shërbime të dalluara;
- Viti 2022, Certifikatë shërbime të dalluara.

✓ *Nga verifikimi i të dhënave të administruara në dosjen personale të punonjësit, rezulton se DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT ËSHTË I SAKTË.*

VLERËSIMET E PUNËS

Në dosjen personale të subjektit të vlerësimit, për periudhën 2018-2023, rezulton se janë të administruara 3 (tre) vlerësime të aftësive individuale të punës në të cilat është vlerësuar si vijon:

- *Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 86 pikë (shumë mirë)*
- *Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 27 pikë (shumë mirë)*
- *Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 28 pikë (shumë mirë)*

Në vlerësimet e mësipërme vlen të theksojmë se në periudhën 2018-2021, vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte 28 pikë, ndërkohë nga viti 2022 e në vazhdim vlerësimi maksimal është 100 pikë.

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtëpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimi dhe organizimit të punës.

- ✓ **Bazuar në sa vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të punonjësit, konkludohet se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.**

MASAT DISIPLINORE

Nga verifikimi i dosjes personale dhe sistemit RMIS, nuk rezulton të ketë masë administrative në fuqi sipas legjislacionit përkatës.

ECURIA NË KARRIERË

Subjekti Besnik Kongjonaj, ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 34 vitesh. Nga verifikimi rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare objekt deklarimi, subjekti Besnik Kongjonaj ka ecurinë si më poshtë vijon:

- 22.06.2023- 20.06.2024 ka ushtruar detyrën Zëvendës drejtor për Sigurinë Publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.
- 01.06.2022-21.06.2023 ka ushtruar detyrën Zëvendës drejtor për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier.
- 01.06.2017-31.05.2022 ka ushtruar detyrën si Shef i Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë.

Subjekti i Vlerësimit, Z. Besnik Kongjonaj, aktualisht mban gradën Drejtues sipas Urdhërit Nr. 1249 datë 24.05.2022.

- ✓ **Në përfundim, në lidhje me ecurinë në karrierë të subjektit të vlerësimit, Z. Besnik Kongjonaj, arrihet në konkluzionin se funksionet që ka ushtruar ndër vite janë në përputhje me ecurinë në gradë dhe në zbatim të legjislacionit rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

✚ PJESËMARRJA NË KONFERENCA SHKENCORE, WORKSHOP-E, SEMINARE, BOTIME BRENDIA DHE JASHTË VENDIT.

Subjekti i vlerësimit, Z. Besnik Kongjonaj, ka deklaruar pjesëmarrjen në konferenca dhe ëorkshshop-e brenda dhe jashtë vendit, por të pa vërtetuara me dokumentacionin përkatës.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit ka kryer një hetim të thelluar të kontrollit të pasurisë, së subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të, kontrollit të figurës dhe profesionalizmit të subjektit, nëpërmjet analizës dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit dhe korrespondencës me institucionet ligjzbatuese.

✓ *Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1 të nenit 47 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*

a) është i përshatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;

b) ka vlerësime pozitive pune;

c) ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit **Z. Besnik Kongjonaj**, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Besnik Çerçiz Kongjonaj**, me funksion aktual Drejtor i Qendrës së Mbyllur të të Huajve.

2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Subjektit të Vlerësimit si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së Vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 07.11.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Loreta HANXHARI

Kryesuese

Bora VRENJO

Relatore

Henri NAQELLARI

Anëtar